



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 985/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Rasim Neziri nga Komuna e Gjakovës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në raundin e dytë, fotografimit të votës gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se qendrën e votimit 0202x/08, në shkollën “ Yll Morina ” në Gjakovë në orën 08:15, Rasim Neziri me numër personal 217334667, ka bërë fotografimin e fletëvotimit. I njëjti është paralajmëruar nga Kryetarja e Komisionit të mos bëjë fotografimin e fletëvotimit, por nuk i është bindur kërkesave të saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të KDI ndaj Rasim Neziri nga komuna e Gjakovës. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe janë të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 985/2013 më datën 04.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.